



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.1030/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – DHOMA E SHKALLËS SË DYTË, e përbërë nga gjyqtari individual Franciska Zhitija-Ymeri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, dhe me seli në Prishtinë, ndaj debitorit “Albi Trans” Sh.p.k., me numër të biznesit 70430521 dhe me seli në fshatin Leshan, Komuna e Pejës, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykata Komeriale-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1408/22 dt.29.05.2023, me datën 22.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.Aprovohet e themeltë ankesa e debitorit “Albi Trans” Sh.p.k., me numër të biznesit 70430521 dhe me seli në fshatin Leshan, Komuna e Pejës, dhe **Anulohet** aktvendimi i Gjykatës Komeriale-Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1408/22 dt.29.05.2023, dhe çështja kthehet në rivendosje gjykatës së njejtë.

A r s y e t i m

Gjykata Komeriale-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr. 1408/22 dt.29.05.2023, ka hedhur poshtë si të pa afatshëm prapësimin e debitorit “Albi Trans” Sh.p.k., me numër të biznesit 70430521, i ushtruar kundër urdhërit për lejimin e përmbarimit P.nr.231/20 datë 07.10.2020, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Shpend Ahmetaj.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar debitori, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të aplikimit të gabuar të të drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit dhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështje të kthehet në rivendosje Dhomës së Shkallës së Parë.

Dhoma e Shkalles së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori “Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale”, me seli në Prishtinë, me datën 07.10.2020, ka paraqitur propozim për përmbartim, ndaj debitorit “Albi Trans” Sh.p.k., me numër të biznesit 70430521 dhe me seli në fshatin Leshan, Komuna e Pejës, në bazë të Vendimit Nr.3591 të datës 15.10.2018, lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, në vlerën prej 7,456.25 euro.

Përmbartuesi Privat, duke vendosur lidhur me propozimin për përmbartim të kreditorit ka nxjerrë aktvendimin P.nr.231/20 të datës 07.10.2020 me të cilin e ka lejuar përmbartimin.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit më datën 10.03.2021, prapësim ka paraqitur debitori, me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi propozimin për përmbartim për shkak se aktvendimi nuk përmbushë kriteret e dokumentit të besueshëm, i njëjti është pa tירpare të dokumenti përmbartues në kuptim të nenit 71 par.1, pika 1.1 të LPP-së, dhe si i till nuk paraqet titull ekzekutiv për lejimin e përmbartimit. Ka shtuar se, aktvendimi përmban shkelej ligjore, për arsye se debitori disa herë ka bërë kërkes për dhënien e pëlqimit, mirëpo ka marrë përgjigje negative e shpesh herë nuk ka marrë përgjigje fare. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që ta arpojoj si të bazuar prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të shfuqizohet.

Kreditori, në përgjigjen në prapësim ka theksuar se prapësimi i debitorit nuk përmban shkaqe për të cilat urdhri mund të anulohet, në kuptim të nenit 71 të LPP-së. Ka shtuar se pretendimet e paraqitura në prapësim janë të pabazuara ngase nuk i referohet asnjë dispozite ligjore. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar.

Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë – Departamenti Ekonomik, pas analizimit të shkresave në lëndë dhe prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1408/22 të datës 29.05.2023, me të cilin e ka hedhë poshtë si të pa afatshëme prapësimin e debitorit, duke vendosur si në dispozitiv të të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se Urdhri Përmbarimor P.nr. 231/20 të datës 07.10.2020, është tentuar ti dorëzohet me datë 12.10.2020, mirëpo që debitori ka refuzuar ta pranoj urdhrin përmbarimor, fakt ky i cili vërtetohet nga fletë kthesa që gjendet në shkresat e lëndës. Ka shtuar se prapësimi nga ana e debitorit është ushtruar me datën 10.03.2021, ndërsa sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore përcaktohet se “ *Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrin përmbarues*”, ndërsa me nenin 126 par. 2 të LPK-së, përcaktohet se “*Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.*” Kështu gjykata e shkallës së parë ka vlersuar se duke marrë parasysh faktin se në rastin konkret debitori urdhrin përmbarimor P.nr.231/20 të datës 07.10.2020, e ka refuzuar për ta pranuar me datën 12.10.2020, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 13.10.2020, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 19.10.2020. Meqenëse në rastin konkret i autorizuari i debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 10.03.2021 e cila vërtetohet nga vula pranimit të përmbaruesit Privat, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar edhe në mënyra tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me vonesë.

Gjykata Komerciale e Kosovës–Dhoma e shkallës së dytë qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë tani për tani nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar është përfshirë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, si dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Kjo gjykatë nga shkresat e lëndës vëren se në procedurën e zhvilluar pranë përmbaruesit privat i është dorëzuar debitorit propozimi për lejimin e përmbarimit me datën 12.10.2020, për të cilën zyrtarët e postës kanë konstatuar se “pala refuzon”, ndërsa me procesverbalin e datës 08.03.2021 nga përmbaruesi privat konstatohet se debitorit i është dorëzuar propozimi për lejimin e përmbarimit për herë të dytë” dhe pas marrjes së propozimit për lejimin e përmbarimit debitori ka ushtruar prapësim me datën 10.03.2021.

Dhoma e Shkallës së Dytë nga shkresat e lëndës ka gjetur se nga fletëkthesa e datës 12.10.2020 zyrtarët e postës kanë konstatuar se debitori “refuzon” mirëpo nuk kanë dhënë asnjë arsye lidhur me refuzimin e marrjes së urdhërit përmbarues ashtu si që është e përcaktuar me nenin 112 të LPK-së me të cilën parashihet se “ *Kur personi të cilit i është dërguar shkresa, përkatësisht anëtari i rritur i familjës së tij, përkatësisht personi i autorizuar ose i punësuar në organin shtetëror apo në personin juridik, pa ndinjë arsye të ligjshme refuzon ta marrë në dorëzim shkresën, dorëzuesi do t’ia lejë në banesë ose në lokalet në të cilat punon personi i tillë apo do t’ia bashkëngjisë shkresën në derë e banesës apo lokalit të punës. Në fletë dërgesë do të shënohet dita, ora dhe shkaku i refuzimit të marrjes si dhe vendi ku është lënë shkresa, komunikimi i kryer në këtë mënyrë quhet i ligjshëm,*” e njejta është shënuar edhe në kopertinë për dorëzim, e që në rastin konkret zyrtarët e postës përveq mbishkrimit “pala refuzon” nuk ka dhënë as një shënim të vetëm si që është ditën, orën dhe shkakut e refuzimit, e po ashtu gjykata e shkallës së parë këtë dispozitë fare nuk e ka trajtuar në mënyrë që të jap vlerësim se dorëzimi a është bërë në mënyrë të rregullt.

Kjo gjykatë vlerësoj pretendimet ankimore si të bazuar ngase me nenin 110 paragrafi 1 të LPK-së parashihet se “*Padia, përgjigjia në padi, letërthirje për në seancë, urdhërpagesa, aktgjykimi dhe aktvendimi, kundër të cilit lejohet ankim i veçantë, mjeti i goditjes së vendimit, i dorëzohet personalisht palës, gjegjësisht përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit me prokurë të saj. Shkresat e tjera do t’i dorëzohen personalisht adresatit kur një gjë e këtillë shprehimisht prashihet me këtë ligj apo kur gjykata konkulldon se për shkak të dokumenteve origjinale që i janë bashkëngjitur shkresës që duhet dorëzuar, ose nga donjë shkak tjetër, nevojitet kujdes i shtuar*”, ngase kjo dispozitë rregullon mënyrë e dorëzimit të shkresave e që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë as këtë dispozitë nuk e ka trajtuar, si dhe nuk ka dhënë as një arsye se pse e mori për bazë fletëdorëzimi e datës 12.10.2020 e jo dorëzimin që i është bërë debitorit përmesë procesverbalit të datës 08.03.2021 apo fletëkthesës së datës së njejtë.

Andaj, në riprocedurë, gjykata e shkallës së parë duhet që ti evitoj të metat e lartë cekura, ashtu që të vlerësoj se cili nga dorëzimet janë të vlefshme ai i datës 12.10.2020 apo ai i datës 08.03.2021, e më pas të merë një vendim të ligjshëm dhe të drejtë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika d) të LPK-së, e në lidhje me nenin 17 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-DHOMA E SHKALLËS SË DYTË

K.DH.SH.II nr.1030/23, me datë 22.03.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija-Ymeri